



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. Bo-29614 /2023

Klinë, dt. 23.08.2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në gazetën zyrtare, me dt. 04.06.2008 nr.28, në nenit 91 paragrafi 1 i Statutit të Komunës së Klinës të dt.07.04.2010, si dhe duke marrë parasysh dispozitat e U.A nr.07/2016 të MTI për Procedurat e Shitjes së Mallrave më Ankand Publik, Kryetari i Komunës së Klinës, mori këtë;

V E N D I M

*Për formimin e komisionit për zhvillimin e procedurave
për shitjen e mallrave më ankand publik*

1. **FORMOHËT**, komisioni komunal për zhvillimin e procedurave për shitjen e mallrave më ankand publik. Përbërja e komisionit është siç vijon:
 - 1.1. **Muhamet Gashi;**
 - 1.2. **Astrit Muhaxheri;**
 - 1.3. **Anëtari i trete emërohet rast pas rasti.**
2. Detyrat e komisionit për zhvillimin e procedurave janë: përgatitja e ftesave për ankand publik, përgatitja e listës së mallrave të cilat do të shiten më ankand dhe çmimin fillestar të tyre, të përgatitur nga njësia e logjistikës, përcakton datën, afatin kohor dhe vendin e prezantimit të mallrave para shpalljes së ankandit, pranon ofertat nga ofertuesit të cilëve duhet t'u lëshohet një dokument më rastin e dorëzimit-pranimin të ofertave dhe të gjithë materialin e pranuar nga ofertuesit përfshirë listën e mallrave më çmim fillestar si dhe listën e ofertuesve ja dorëzon komisionit vlerësues.
3. Mandati i komisionit për zhvillimin e procedurave është dy (2) vjeçar, ndërsa anëtari i trete emërohet rast pas rasti varësisht nga lloji i mallrave dhe natyra e ankandit. Anëtarët e komisionit punën e vete e kryejnë në përputhje me autorizimet e dhëna më këtë vendim si dhe Udhëzimin Administrativ të MTI nr.07/2016 për Procedurat e Shitjes së Mallrave më Ankand Publik.
4. Ky vendim është i plotëfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Te përmendurit;
- Ekzekutivi;
- Arkivi

Kryetari,
Zenun Elezaj *pei*